



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura e III-të**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja Nr. 26  
Prishtinë, më 25.05.2009  
Salla N-225 ora 10,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Heset Cakolli dhe Mark Krasniqi.  
Munguan Enis Kervan Memli Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Dragan Dimiq.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për përudhen 2010 – 2012.**
- 3. Shqyrtimi i dokumentit për Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë - Letrës së Bardhë**
- 4. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Agim Veliu -kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi debat lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, propozoi që Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2010-2012 të shtyhet për mbledhjen e radhës me qëllim që anëtarët e Komisionit të përgatiten për këtë çështje. Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Pasi nuk kishte propozime tjera, kryesuesi propozoi të vazhdohet me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 12.05.2009.

### **3. Shqyrtimi i dokumentit për Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë - Letrës së Bardhë**

**Agim Veliu** – tha se, dokumenti për Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë – Letrës së Bardhë në sistemin Arsimor të Kosovës ballafaqohet me këto probleme: cilësia e arsimit është e ulët, rezultati i fëmijëve është i dobët, mungon infrastruktura shkollore ku në zonat urbane punohet deri në katër ndërrime.

Për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara paraqiten probleme për shkak të mungesë të mësimdhënësve, materialeve mësimore. Në arsimin Kosovarë, fëmijët me nevoja të veçanta janë të përfshirë vetëm 1% ( prej 10 nxënësve 9 prej tyre nuk i ndjekin mësimet). Në bazë të statistikave kjo kategori duhet të standardizohet me 12% si në vendet tjera në rajon. Propozoi se në fushën e arsimit këto çështjet lidhur me Letrën e Bardh për përkrahje sociale të specifikohen më detajisht

**Arsim Rexhepi** –tha se nga takimet me përfaqësues të Komisioneve të tjera do ta njoftoi Komisionin rreth zhvillimeve të fundit lidhur me dokumentin - Letra e Bardhë për përfshirje sociale. Kjo nismë sipas tij ka të bëjë me një koncept të përfshirjes dhe identifikimit të grupeve sociale me grupet e interesit.

Propozoi se sa më parë duhet të bëhet regjistrimi i popullsisë në Kosovë. Kishte vërejtje lidhur me statistikën për komunitetin rom të cilat duhet përmirësuar.

Në fund diskutoi për qasjen e kufizuar bankare dhe lidhur me këtë tha se krijimi i Bankës Qendror duhet të jetë më human sepse normat e interesit janë shumë të larta për qytetarët e Kosovës.

**Gani Buçinca** – tha se dokumenti - Letra e Bardhë parasheh mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ky dokument nuk ka të bëjë me realitetin objektiv në Kosovë por paraqet aspektin teorik dhe të përgjithshëm, andaj propozoi të rishikohet Legjislacioni në fuqi.

Në Kosovë sistemi Arsimor fillor është i garantuar por ka grupe të caktuara të cilët vetë përjashtohen nga ky sistem. Theksoi se komuniteti i ashkalive duhet të përfshihet në paralelet në gjuhën shqipe nga se nuk kanë gjuhë të dytë.

Për ngritjen e mirëqenies së komunitetit rom duhet bërë përpjekje që të rregullohen të drejtat edukativo arsimore të cilat ju përkasin me Konventa Ndërkombëtare. E përkrah dokumentin e Letrës së Bardhë me ndryshime dhe plotësime të dala nga Komisioni

**Mark Krasniqi.** Mendon se ekzistojnë probleme por jo në këtë shkallë siç paraqiten në këtë dokument. Ai nuk pajtohet me të dhënat statistikore që përfshin ky dokument. Theksoi se regjistrimi i popullsisë nuk është i rregulluar se njerëzit të cilët jetojnë në diasporë dhe të cilët kanë statusin si punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme iu mohohet e drejta të regjistrohen në Kosovë. Kjo çështje duhet të sensibilizohet dhe të rregullohen të drejtat e tyre si qytetarë tanë.

**Heset Cakolli** –diskutoi për çështjet e cilësisë së shkollimit të dobët; mungesa e infrastrukturës nëpër shkolla ku punohet në katër nderime; shkalla e regjistrimit para-shkollor në viset rurale është e ulët. Vërejtje tjetër është buxheti i pamjaftueshëm për arsim që paraqet pengesë për rregullimin e cilësisë në arsim, infrastrukturë etj. Në fund konstatoi se me Strategjinë legislative të vit. 2017 do të krijohen kushte dhe mundësi për zhvillimin në arsim. Në parim e përkrah dokumentin e Letrës së Bardhë.

**Drita Kadriu** – tha se në parim mbështet Letrën e Bardhë për përfshirje sociale. Theksoi se gjuha e të shprehurit duhet të jetë gjuhë pozitive. Në këtë dokument çështja e përfshirjes së mekanizmave mbrojtës është i papërshtatshëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga dhuna, trafikimi etj, Ajo diskutoi lidhur me çështjen e të dhënave të cilat pasqyrojnë punën dhe administrimin e UNMIK-ut në këtë 10 vjeçar. Të dhënat nuk mund të jenë të viteve 2006-07 por duhet të jenë të vitit të fundit. Nga enti statistikor janë të dhënat më reale dhe këto të dhëna duhet ti referohen këtij dokumenti.

**Kryetari i Komisionit** - Në këtë dokument kishte vërejtje lidhur me statistikën e marra nga ana e komunitetit serb dhe goran të cilat i konsideron jo të sakta. Propozoi se duhet të kategorizohet grupi i komunitetit pakicë të cilët refuzojnë të punojnë me program arsimor të Kosovës ndërsa i kanë tekste mësimore. Grupi tjetër i pakicave ballafaqohet me mungesë të objekteve, mësimdhënësve, teksteve shkollore. Theksoi se Ministria e Arsimit dhe Strategjia për Arsimin para Universitar 2017, parasheh një dinamikë në eliminimin e problemeve sociale në fushën e arsimit.

#### 4. Të ndryshme

**Arsim Rexhepi** ai propozoi që Komisioni në mbledhjen e radhës ti shqyrtoi këto pika: të bëhen vizita me qëllim që të bëhet shkëmbimi i përvojave në shtetet në rajon dhe më gjerë. Komisioni të marrë iniciativë për ngritjen e moralit të shkrimtarëve, sportistëve të njohur, artistëve dhe estradave muzikore. Diskutoi se në sistemin arsimor duhet të gjendet rruga që të futjen si lëndë, religjioni dhe politika.

Më pastaj, propozoi që për procedurën e shqyrtimit të P/ligjit për Fuqizimin e Rinisë Komisioni të kontaktojë me Komisione të shteteve në rajon dhe më gjerë me qëllim të shkëmbimit të përvojave të tyre.

**Kryesuesi** - përkrahi propozimet e Arsim Rexhepit dhe i sugjeroi që këto pika ti prezantoheshin para komisionit.

**Gani Buçinca** theksoi se duhet të jetë i qartë qëllimi i vizitave dhe të caktohen temat lidhur me këto vizita.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11, 10

Kryetari i Komisionit,  
Agim Veliu